

VIZIONI

Qarku i Lezhës, pjesë integrale e destinacionit të rëndësishëm turistik, Shqipëria e veriut, me një turizëm të qëndrueshëm, të zhvilluar në mënyrë të balancuar: detar, rural , kulturor e të integruar në ekonominë rajonale.

Objektivat

I -Të kemi një Turizëm të qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit.

II -Të zhvillojmë Turizëm të harmonizuar bregdetar, historik e etno-kulturor.

III -Të krijojmë një imazh pozitiv në rritje për zonën tonë dhe atë kombëtare.

IV.Të zhvillojmë agroturizmin

Identiteti turistik i Rajonit të Lezhës, është pozicionuar në tregun kombëtar të turizmit si një destinacion pushimi për detin e pastër e me shumë ditë me diell, për bukuritë natyrore, për trashigimi të pasur në etnokulturë dhe histori si dhe për mikpritjen.

Nuk është aspak e lehtë të gjesh një metaforë , e cila të shpalos me densitetin e duhur, atë produkt estetik, që përftohet nga harmonia gati perfekte e klimës bregdetase, me atë malore, si në këto vise, në këtë reliev, ku natyra afishon një bukuri të pa shoqe dhe njëherësh fsheh si me magji visarin arkeologjik të konservuar ndër mijëvjeçarë

Tradita turistike

Të huajt që kanë vizituar Rajonin tonë si E.Durham, F.Nopça T.Ipen, etj.kanë shkruar edhe për mikpritjen e bujarinë e njerëzve të këtyre anëve.

Prej shekujsh thuhet :

“Shtëpia është e Zotit dhe e mikut”

Nuk mund të flitet për ndonjë traditë të zhvillimit turistik në vendin tonë, për shkak të izolimit me botën dhe varfërisë brenda vendit

Pas luftës së dytë botërore në qendrat e rretheve, funksiononin të ashtuquajturit “Hotele Turizmi”, ku frekuentoheshin kryesisht nga vendasit.

Në Rajonin tonë, kanë funksionuar tre hotele të tilla: Hoteli i Gjuetisë i ngritur në vitet 40 dhe i ideuar nga Konti Çiano , Ishull-Lezhë, Hoteli “Lisus” në qytetin e Lezhës dhe hoteli i qytetit të Rrëshenit. Në qytetin e Laçit, nuk ka patur të tillë, pasi administrohej nga rrethi i Krujës. Këto njiheshin si hotelet më cilësorët, me restorantet e tyre ku serviroheshin prodhime vendase.

Kanë funksionuar në mënyrën e vet ekskursionet kolektive të ndërmarrjeve, shkollave dhe institucioneve të ndryshme në vise me bukuri natyrore të veçantë. Vizitat në “veprat e pesëvjeçarëve”, në muzetë e luftës dhe në muzetë etnografikë , ishin trajtë e turizmit të asaj kohe.

Ishull -Lezhë

Në fillim të viteve '40 është ndërtuar një hotel me një arkitekturë Italiane të veçantë që u quajt “**Hoteli i gjuetisë**”, me ambiente të jashtme të bukura e shlodhëse në një mjedis me drurë, shkurre, lulishte , një liqen i vogël natyral , etj. Për njerzit e thjeshtë ishte një mollë e ndaluar sepse shërbente kryesisht për pritjen e delegacioneve të huaja.

Hoteli i Gjuetisë në Ishull – Lezhë, është pionier i turizmit modern në rajonin e Lezhës.

Një zhvillim të vullshëm mori turizmi në rajonin e Lezhës pas levizjeve demokratike në Shqipëri. Instalimi i tregut liberal, hapi mundësi të mëdha të zhvillimit të turizmit në vendin tonë. Edhe në Qarkun e Lezhës u ngrit një rrjet i gjërë me objekte turistike në bregdet, si dhe në zonat malore. Një varg hotelesh, motelesh, restorantesh moderne e tradicionale ,shtrihen përgjatë bregdetit, duke e bërë atë më atraktiv në shtimin e numrit të turistëve vendas

Monumentet e Kulturës

Lezha, (Lissus antic) është krenare që e ka lindjen e vet te njëkohshme me qytet e tjera antike si Durresi, Apollonia, Shkodra, Berati, Butrinti etj, dhe të gjitha sëbashku përbëjnë djepin e qytetërimit të Shqipërisë së lashtë. Qyteti vazhdon të ketë rëndësi të madhe historike dhe gjatë mesjetës si vendi ku bëhet bashkimi i shqiptarëve për qendresë historike ndaj pushtuesve osmanë si dhe një nga qendrat e Skenderbeut e më pas vendi ku ai vdes e varroset.

Po ashtu Lezha ka kontributin e vet të gjithanshem edhe në kohën e re dhe moderne në përparimin e rajonit dhe të të gjithë vendit.

Lezha, për çdo vizitor vendas apo të huaj ofron vlera unike, arkeologjike, monumentale e historike.

Akrolisi

Gërmadhat e Shëlbuemit “Akrolisi” Në juglindje të qytetit të Lezhës ngrihet maja shkëmbore e Shëlbuemit, 408 m mbi nivelin e detit. Kurora e saj ka qënë rrethuar në lashtësi prej një muri të gjatë dhe dy kulla me gurë të palatuar, duke formuar aty një kështjellë mjaft të mbrojtur. Gërmimet arkeologjike në këtë vëndbanim kanë dhënë gjetje të shtresave kulturore përtej (shek. 11 p.k.) duke e bërë këtë vëndbanim parahistorik, ndër më të hershmet në Shqipëri e më gjërë. Gjurmët më të hershme të qytetërimit në Lezhë. Lissusi (385 p.k) qyteti antik mjaft i zhvilluar e me rëndësi të veçantë arkeologjike dhe historike.

Kalaja e Lezhës

Ngritur mbi themelet e Akropolit antik , pranohet nga të gjithë, se fillimi i ndërtimit të saj i përket shekullit të 8-të. Kalaja ka njohur shumë faza ndërtimi, për të ardhur në atë të fundit të vitit 1520, nga Sulltan Selimi i I- rë. në literaturën historike dhe arkeologjike kalaja e Lezhës njihet për një kohë të gjatë me emrin Kështjella e Elisonit. Ajo ka tre porta të cilat ishin mjaft të mbrojtura nga kulla e kthina të maskuara, të cilat të favorizuara nga pozicioni gjeografik e bënë atë të pamposhtur. Në vitin 2002 pas restaurimit të themeleve të Kalasë Mesjetare u vu re se trashësia e mureve arrinte deri në 4.30 m, nga 3.50m trashësi që mendohej të ishte më parë. Deri më sot janë zbuluar 12-porta dhe 48-kulla mbrojtëse.

Obelisku

Në qëndër të qytetit ndodhet një monument që është ngritur në kujtim dhe ndërtim të ngjarjes së rëndësishme që ndodhi në Lezhë në 2-Mars 1444. Me këtë datë heroi ynë Kombëtar mblodhi në këtë qytet, zoterimin venedikas, shumicën e krerëve feudal shqiptar, për ti bashkuar në luftën kundër perandorise osmane. Kuvendi i Lezhës bashkoi forcat e shqiptarëve dhe emëroi Skënderbeun si udhëheqës ushtarak të tyre. Kuvendi i Lezhës që forma e parë e bashkimit juridik të princërve shqiptarë, duke kapërcyer cilësisht nga epoka e principatave të vecanta në epokën e bashkimit dhe njësisë së kombit shqiptarë. Në përkujtim të kësaj ngjarjeje të vecantë është ndërtuar Obelisku në vitin 1968 me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Më 2 Mars të cdo viti, Bashkia, banorët e Lezhës dhe personalitete të larta shtetërore nderojnë dhe përkujtojnë me respekt përvjetorët e kësaj ngjarjeje më rëndësi të madhe kombëtare.

Memoriali ose Vëndvarrimi, është ndërtuar mbi kishën e Shën Kollit, aty ku në vitin 1468 u varros Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ajo që shihet tani nuk ka të bëjë fare me ndërtesën e dikurshme që i përket shek, 15-të. Pasi me 1478 turqit pushtuan qytetin e Lezhës shkatërruan dhe hapën varrin e Gjergj Kastriotit, vdekur me 17-janar 1468, duke mbështjelle eshtrat e tij me flori e argjend për ti përdorur si hajmali të pathyeshmërisë në beteja. Memoriali u ndërtua në vitin 1981. Në dyshemene e anijates ngrihet busti i Skënderbeut, punuar nga skulptori i popullit Odhise Paskali. Mbi pllakën e mermerit janë vendosur kopje të shpatës dhe përkrenares prej bronxit. Në brendësi të mureve ka një varg mburojesh me stemat e fiseve që morën pjesë në Kuvendin e Lezhës.

Shtëpia e Mlikajve, (Shtëpia e Esat Mlikës, lagjia “Skënderbeg” buzë Drinit. Është një banesë popullore qytetare dykatëshe, ka vlera arkitekturore në punimin e mureve, çatisë, dritareve e dyerve (ka qenë ish- muzeu i qytetit), është një banesë tipike qytetare e Lezhës

Ura e Vjeter (Është ura më e vjetër e ndërtuar mbi lumin Drin. Ajo paraqet për vizitorët vlerat e saja historike dhe artsitike.

MONUMETET E KULTURES QE MBROHEN NGA SHTETI

Bashkia Lezhë

- Rrënojat e Akrolisit(Mali I Shelbumit)
- Rrënojat e qytetit te Lissit
- Vëndvarrimi I Skenderbeut
- Ura e Plakut Gjon në fshatin Rraboshtë
- Kisha e Shen Barbulles në fshatin Pllanë
- Ura e Shkinës në fshatin Piraj
- Kisha e Shen Aleksandrit –Boikon Spiten
- Kisha e Shen Venerandës(Shen Premtes)-Balldren
- Kisha e Shen Stefanit – Blinisht
- Kisha e Shen Mhillit – Nenshat
- Banesa e Sali Bajramit – Varosh Lezhë

- Banesa e Esat Mlikës – Lezhë
- Banesa e Geg Prendit –Patalej
- Banesa e Ndue Frrokut- Ishull-Lezhë
- Kalaja e Lezhës

Bashkia Kurbin

1. Kisha e Shen Mërisë – Mamurras
2. Kalaja e Sebastes - Laç

Bashkia Mirditë

- Kalaja Antike e Rubikut
- Gradishta në Domgjon, komuna Fan
- Kisha dhe Manastiri I Rubikut
- Ujësjiellësi i Domgjonit, komuna Fan
- Banasa e GJetë Markut-Perlat i Epër, komuna Kthellë
- Banesa e Dodë Nikoll Gjokolës- Kurbnesh, komuna Selitë
- Banesa e Preng Lleshit- Mashterkor, komuna Orosh
- Banesa përdhese dhe kulla e Zef Ndocajt në Kodër Spaç, komuna Orosh

Monumentet Natyrore

Në rrethin e Lezhës ndodhen monumente natyrore që mbrohen nga shteti.

Bashkia Lezhe

- Rëra e Hedhur
- Rrapi i Grykës
- Rrapet e Kolshit
- Shpella e Hutit
- Shpella e Sukës së Vogël
- Rivat e Drinit
- Këneta e Kashtës
- Rrapi i Pirajve
- Lisi i Markatomajve
- Pylli (dushk, frashër, shkozë e Shenmisë Kallmet 1 ha)
- Dritarja Tektonike e Manatisë

Në rrethin e Mirditës ka objekte të shpallura monumente natyrore .

Bashkia Mirditë

- Kanioni i Shehut të keq
- Shpella Kusia e Ndue Gjoni
- Rrobulli i Blaçit
- Guri i Gjonit
- Guri i nuses
- Kroji i Bardhë

- Mrizi i Shenaprenës
- Rrapi i Kaçinarit
- Lisat e Shpalit
- Lisat e Marpepës

Në Kurbin ndodhen disa objekte të rëndësishme historike, arkeologjike religjioze etj, si dhe monumente natyrore.

Bashkia Kurbin

- Tarraca detare e Laçit
- Gryka e Shkopit
- Frashëri Kurbin
- Lisat e Shënmhillit
- Plepi i Bardhë
- Shpella e Shenavlashit (Shenandoi)
- 7. Gështenja e Vjetër
- Ishulli i Cabakut
- Kordoni litural i Bregut të Ri
- Selvitë e Shenmërisë

Rrapi në Dauel

Ndodhet në fshatin Dauell të Komunës Milot. Ai është qindra vjeçar dhe është i shpallur monument natyror.

Laguna e Patokut

E njohur dikur si “ Plazhi i Patokut” është një areal i pasur me florë dhe faunë . Kjo zonë vazhdon të pasurojë traditën e mirë të kuzhinës ku shërbehet peshk i freskët .

Zona është e pasur me një bimësi të shumëllojshme që të fton për pushime cilësore

Lugina e Matit

Bashkë me hidrocentralin e Shkopetit është një ndër viset që shpalos bukuri të rrallë natyrore.

Përgjatë brigjeve të Matit ka mjaft lokale ku shërbehet kryesisht në mënyrë tradicionale

Gurra e Domgjonit

Është i ujësjellësi i lashtë një monoment origjinal si për funksionin ashtu edhe për arkitekturën e tij.Sot ruhet një pjesë e tuneleve nëntoksore si dhe pusi i kontrollit.

Tuneli asht hapur në galeri horizontale veshur me mure anësore, ndërsa nga sipër mbuluar me qemer. Gjërësia e tunelit lëviz nga 80 cm deri në 1.3 m, për masa që lejon kalimin e njeriut me trup të përkulur.

Rreth 100 m nga dalja e tunelit nëntokësor, është ndërtuar pusi i kontrollit, që nis me një hyrje mjaft të maskuar nga sipërfaqja e tokës. Nga hyrja për në fundin e pusit zbritet me anë të 23 shkallëve guri në formë spiralje të vendosura në faqet e brendshme murore të pusit . Gjërësia e pusit shkon deri në 2.15 m, lartësia e pusit është 8 m, në fund është puseta e kontrollit.Ujësjellësi i Domgjonit është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë dhe pa pararele në të gjithë ballkanin. Ndërtuesit e saj kishin një traditë të shquar në punimet nëntokësore si nxjerrës të mineraleve (pirusët) .

Shpellat e Grykës së Valit

Ky objekt unikal është shpallur “ Monoment kulture” dhe mbrohet nga shteti.

Janë 4 shpella të vendosura midis fshatrave Perlat i Epër, Lufaj, Laç-Bruç, me emrat:

Shpella e Nezirit, e Këputës, e Pëllumbave dhe e Valit.

Janë të gjitha shpella masive të krijuara në shkëmbinj gelqeror, si rrjedhojë e grryerjeve karstike. Format e tyre të përshtatshme kanë bërë që banorët e hershëm ti përdornin për banim. Këtë fakt e dëshmojnë gërmimet arkeologjike dhe objektet e gjetura në to.

Shutrrea

Është një lum i nëndheshëm që ndodhet midis Kurbneshit dhe Merkurthit, në Grykën e Selitës rreth 20 m mbi lumin Urak. Në sipërfaqe të tokës është një pus i thellë rreth 30 m nga ku kalon uji me shushurimin e tij të përjetshëm. Hamendjet për rrugën që ndjek ky lum i nëndheshëm janë nga më të ndryshmet, por deri tani është vertetuar se nuk ka lidhje me lumin e Urakës

Lisat e Marpepës

Dymbedhjetë lisa në një kodrinë në bregun e Fanit të vogël, buzë rrugës që shkon në Mashtëkor dhe degëzimit për në Grykë Orosh , ku janë zhvilluar shumë kuvende.

Rrapi i Kaçinarit

Çinari, përndryshe Rrapi i Kaçinarit, është një dru natyror monumental, me një moshë të papërcaktua. Por natyrisht mjaft i hershëm, aq sa besohet se edhe emri i vendit rrjedh prej tij. Kaçinari është i dëshmuar si emër që në shekullin e XV. Në afërsi të çinarit është kisha, dhe ajo e vjetër. Në hijën e rrapit janë zhvilluar kuvende historike të zonës. Ky rrap edhe sot të befason me madhësinë, moshën dhe misterin e vet.

Bargjana

Është gurra më e madhe e më e rëndësishme në Mirditë që buron në majë të një shkëmbi të bardhë, në të djathtë të lumit Fan i Vogël. Ujë e Bargjanës së shpejti do të ndrojë rrjedhë për tu ardhur në ndihmë banorëve në Rrëshen, Tarazh, Prosek, Malaj, Përlat, Kodër Rrëshen etj. Ai do të jetë ujësjedhësi më i fuqishëm dhe më modern i Mirditës.

Kroi i Bardhë

Në Komunën e Selitës, në mes të malit të Dillës e të Kunorës ndodhet një burim që njihet me emrin: Kroi i Bardhë. Ujit e Kroit të Bardhë ka vlera të rralla kurative, pasi ndikon në shërimin e disa sëmundjeve, si atyre të rrugëve urinare, laringut, stomakut, veshkave, tiroideve etj. Tërheqës është edhe mjedisi turistik edhe ekologjik i kësaj pike turistike të Komunës së Selitës. Gjithnjë është folur për rëndësinë e një investime në këtë pikë të rrallë, që nënkupton ndonjë kamping, hotel e mjedise të tjera për frekuentuesit. Vendburimi i Kroit të Bardhë është 1350 m mbi nivelin e detit, me prurje 18 litra/min dhe temperaturë 3-4 °C uji kalon midis shkëmbinjëve ultra bazikë, duke përfituar përmbajtje mineralogjike të larmishme që veprojnë në organizmin e njeriut.

Ndodhet 55 km në lindje të qytetit të Rrëshenit.

Herën e parë që u shpalo si mikrokamping ka qenë fundi i shek. XIX ku frekuentuesi i parë ishte prifti i famullisë së Selitës

PLAZHET

TURIZMI BREGDETAR

Qarku i Lezhe kufizohet në pjesën perëndimore me detin Adriatik, kështu që turizmi bregdetar mbetet më kryesori. Rajoni ka një sipërfaqe turistike bregdetare afro 11 000 ha, vijë bregdetare prej 38 km (duke filluar nga Kepi i Rodonit dhe deri në Velipojë), me plazhet e mrekullueshme të Shëngjinit, Tales, Patokut, Godullit etj. Gjerësia e brezit bregdetar prej 3 km përbën një tjetër favor për zhvillimin e turizmit.

Plazhi i Shëngjinit

Është një prej plazheve më të përmendur të veriut të Shqipërisë, i njohur veçanërisht për kualitetin e rërës. Gjendet 8 km larg qytetit të Lezhës. Këtu ka 200-300 ditë me diell në vit. Në veri të plazhit të Shëngjinit në një largësi prej 2.5 km, rrëzë kodrave të Rencit, gjendet i mbrojtur nga erërat plazhi i mrekullueshëm i “Ranës së Hedhun”.

Ndër plazhet më të frekuentuara si nga pushues vendas ashtu dhe të huaj mbetet plazhi i Shëngjinit ku fluksi ditor i pushuesve varion nga 40 000 (në ditë të zakonshme) deri në 90 000 (në fundjavë). Pushuesit janë kryesisht nga 3 rrethet e Qarkut Lezhë, por edhe nga Shkodra, Kruja dhe kryeqyteti.

Rruga e Kombit, Durrës-Kukës-Morinë, rritur me 30 % numrin e pushuesve kosovarë dhe shqiptarëve të Maqedonisë

Në plazhin ranor që ofron Shëngjini me shetitoren e re dhe një varg investimesh në gjithë infrastrukturën e bregut, turizmi sa vjen dhe njeh zhvillim të vrullshëm. Pastërtia e detit, ajri i pastërt si dhe qetësia që ofron ky plazh përthith çdo vit e më shumë turistë të huaj dhe vendas, të cilët shprehen të kënaqur nga shërbimet e ofruara. Njësitë akomoduese, të cilat ofrojnë një shërbim cilësor, shtrihen në një pjesë të madhe të gjatësisë së plazhit. Këto janë ndërtime të viteve të fundit dhe nuk mungojnë baret, restorantet, diskot etj, të cilat plotësojnë më së miri kënaqësitë e turistëve.

Plazhi i Shëngjinit me disa pika pothuajse të virgjëra është një premisë për ndërtimin e fshatrave turistike, të cilat kanë nisur të ndërtohen me inisiativa private.

Plazhi i Tales

Edhe plazhi i Tales, në Komunën e Shënkollit, deri më dje “i virgjër”, pas përfundimit të ndërtimit të rrugës lidhëse me autostraden Lezhë-Tiranë, po popullohet çdo ditë dhe më tepër, dhe çdo sezon po e rrit ofertën turistike. Investimet e vazhdueshme infrastrukturore, por dhe zgjerimi i rrjetit të hoteleve dhe njësive të shërbimit nga investorët vendas, po e kthejnë Plazhin e Tales në një destinacion të rëndësishëm të turizmit detar e familjar.

TURIZMI MALOR

Qarku i Lezhës ka mjaft pasuri turistike ekologjike, malore dhe alpine. Ndër pasuritë e këtij turizmi mund të veçojmë: pyjet, burimet, bimësinë, monumentet e natyrës etj. Këto pasuri

shfaqen në një sipërfaqe prej 93 264 ha, në zonën kodrinore dhe malore të qarkut. Masivet malore të shumta me lartësi të mëdha mbi nivelin e detit me pyjet, livadhet dhe burimet krijojnë bukuri të rralla dhe mundësi për zhvillimin e turizmit malor dhe alpin, kryesisht në bjeshkët karakteristike si: Kunorë, Munellë, Orosh, Selitë, Xhuxhë (në Mirditë), Trodhne (në Kurbin), Malung dhe Velë (në Lezhë).

Interesante shfaqet Mirdita e nëndheshme, jo vetëm për pasuritë nëntokësore e për zgafellat që hapi dora e njeriut, por edhe për shpellat karstike që gjenden në malet e kësaj krahine si :

Shpella e Valit, Komuna Kthellë, Shpella e Mërkurthit në fshatin Mërkurth të Selitës (e pa eksploruar deri tani), Shpella e Fretërve në Lufaj të Selitës, Shpella e Akullit në Orosh, Gurra e Domgjonit në Komunën Fan, Shpella e Fatmirave në komunën Selitë, Shpella e Shutresë në Grykë të Selitës.

Turistët e aventurës, por edhe speleologët, të cilët nuk kanë munguar t'i eksplorojnë këto shpella pas viteve 90-të, që janë një destinacion befasues turistik.

Kurbini dhe Mirdita, por dhe pjesa malore e Lezhës ka adresime të këtij turizmi.

Ndër bukuritë natyrore dhe me vlera kurative është Kroj i Bardhë në Bjeshkët e Kunorës dhe të Valmorit (në Selitë Mirditë). Është ujë kurativ për shumë sëmundje të ndryshme ndaj dhe vizitohet jo vetëm nga vendas por dhe turistë të huaj.

Turizmi fetar

Ndër vlerat më të spikatura të historisë dhe të kulturës shqiptare është bashkjetesa ndërfaqetare. E tillë shpaloset ajo edhe në Qarkun e Lezhës, i cili ka një strukturë religjioze, ku rreth 72% e popullsisë janë të besimit katolik, 25% janë të besimit myslyman dhe 3% të besimeve të ndryshme. Nuk ekziston asnjë rast i konflikteve mes besimeve. Respekti reciprok për njëri-tjetrin është shembullor.

Në atlasin e objekteve të kultit, kemi 4 lloje prej tyre:

Kishën katolike, kishën ortodokse, xhaminë dhe teqen.

Ky atlas , është i pasur me objekte mjaft të moçme të krishtërimit të hershëm në Shqipëri.

Historiku i kishës katolike ka mbartur dy momente ë rëndësishme nëpër 15 shekuj të veprimtarisë së vet. Ajo ka përjetuar rënien gjatë shekullit të parë të pushtimit osman dhe rënien e dytë gjatë dimrit ateist të vitit 1967.

Ky dimër, nuk rrafshoi vetëm kishat katolike e ortodokse, por të gjithë objektet e kultit në Shqipëri. Këto objekte u kthyen në të ashtuquajturat shtëpi kulture, por jo rradhë edhe në depo për ekonomitë bujqësore. Disa prej tyre u kthyen në rrënoja.

Objektet u shembën, por asnjë herë nuk u shemb besimi te Zoti.

Në vitim 1990, shteti i diktaturës komuniste e lejoi besimin fetar, të cilin e kishte ndaluar me kushtetutë. Epoka e ndryshimeve të mëdha e viteve 90, hapja e Shqipërisë drejt perëndimit e ringjalli besimin dhe bëri që mbi rrënojat e objekteve të kultit të ngrihen

katedrale e kisha ,teqe e xhami.

Dioqeza e Sapës dhe ajo e Lezhës si dhe Dioqeza e Mirditës ,e cila pasoi Abacinë e Oroshit, kanë vlera të pa diskutueshme me interes për tu vizituar.

TURIZMI RURAL DHE FAMILJARË

Turizmi rural dhe ai familjar nuk kanë ndonjë traditë të pasur,por dekadën e fundit oferta gjithëvjetore e këtij produkti po konkuron në tregun turistik rajonal.Menaxhimi I kësaj dege të rëndësishme kërkon një bashkëpunim të vazhdueshëm me prodhuesit e fshatit si me perime e fruta ashtu edhe me prodhimet blektorale.Në bregdet ,por dhe në gjithë zonën rurale ,po shtrihet rrjeti I lokaleve e hoteleve me sherbime konkruuese.Zhvillimi I infrastrukturës rrugore në gjithë territorin po e faorizon zhvillimin e turizmit rural dhe familjar.Aktualisht po bahet perpjekje qe dhe në zonat e thella për turistët e aventures të kene si rezidenca kullat dhe shtepitë e boshatisura nga migrimet ne zonat e ulta.

Folklori

Ne këtë rajon janë ruajtur shumë tradita kombëtare si në veshje, instrumenta, këngë etj. Prandaj për ofertën turistike të rajonit është mjaft e rëndësishme organizimi i manifestimeve folklorike dhe format tradicionale të jetës e veprimtarisë së tij. Turizmi nëpërmjet manifestimeve kulturore dhe vleresimit të tyre ndikon në ruajtjen e folklorit, kultivimin e tij dhe ngritjen e nivelit artistike të tyre. Rajoni trashëgon dhe kultivon një thesar të pasur e të bukur folklorik ku pasqyrohet vitaliteti, kultura materiale dhe shpirtërore dhe ndenja fisnike. Është e vërtetë që kostumet popullore dhe orendite e traditës nën përvetësimin e jetës moderne janë zhdukur nga përdorimi i perditshëm, por ato mund të shihen dhe gjenden me tërë bukurinë dhe finesën e tyre artistike në manifestimet folkloristike e në muzetë etnografike.

Për mungesë ambientesh nuk funksionon një muze, por potencon gjithë inventarin e veshjeve popullore të rrethit të Lezhës dhe shquhet për vlerat burimore , të cilat ruhen mirë.

Në Lezheë ka vite që zhvillohet Festivali i Lahutarëve ,në të cilin marrin pjesë nga gjithë Veriu i Shqipërisë dhe nga vise të tjera të Ballkanit.

Artizanati

Është pjesë e ekzistencës dhe jetesës, ruajtur dhe mbartur brez pas brezi nga banoret e ketyre trevave, që nga lashtesia e deri në ditët tona. Zhanre te ndryshme të muzikës, këngëve, elegjive, valleve, interpretuar nga mbartesit e tyre, si dhe koloritet e mrekullueshme të kostumografisë së kësaj treve, jane vlera te rendesishme të kulturës sonë kombëtare të trashëguara ndër vite nga banorët e këtushëm. Këtu dallojmë një tashëgimi të gjërë etno-kulturore të pothuajse të gjitha viseve të shqipërisë së Epërme, diktuar edhe nga migracionet e shumta që ka patur ndër vite kjo trevë, si dhe ruajtja e

vlerave prej nga kanë ardhur banorët e këtushëm.

Artizanët, sidomos ata të Zadimës, po vazhdojnë traditën e moçme me punime mjaft cilësore, të cilat pëlqehen shumë për kolorin dhe mjeshtrinë ethurjes e qendisjeve të veshjeve e paisjeve tradicionale

Kuzhina tradicionale

Kuzhina karakteristike tradicionale është ndërthur me atë perëndimore. Ndër gatimet që spikasin në rrethin e Lezhës janë gatimet me peshk, ku të preferuara janë qefulli, barbuni, frutat e detit, ku përmendim kallamarë, sepie, karkalecë. Këtu gjithcka është e freskët. Gatime të vecanta janë ato me shpendë e lagunave, të Kune-Vainit. Në pjesën veriore të Lezhës, shtrihet Zadrima, ku prodhime tipike këtu mund të përmendim gjelin e detit, ku më të përmendur në mbarështimin e gjelit të detit janë fshatrat Kodhel dhe Kotërr. Shumë i shijshëm është edhe djathi Zadrima. Fshati Kallmet dhe zona përreth dallohet edhe për prodhime të tjera tipike dhe shume të shijshme si vaji i ullirit, kallmet, fasule kallmet. Fshati Gjader është i përmendur për prodhimin e mjaltit të sherbelës, mjalt i rrallë dhe me vlera kurative. Këtu bletarët prodhojnë edhe qumësht Mbretëreshe (blete), i cili shquhet për cilësitë e tij të rralla rigjeneruese për trupin dhe trurin e njeriut. Ndërsa zona në juglindje të Lezhës, ku shtrihet Malësia e Lezhës dallohet për prodhimin e mjaltit të shqopes, mjalt shumë kurativ sidomos për veshkat

Turizmi lagunor

Krahas lumenjëve, rezervuareve e liqeneve artificial në qarkun e Lezhës kemi edhe një pasuri tjetër mjaft të rëndësishme për nga vlerat që ato paraqesin si për biodiversitetin ashtu edhe për fusha të tjera ekonomike që janë turizmi, peshkim, gjuetia atj.

Lagunat që ndodhen në Qarkun e Lezhës janë :

Laguna e Kënallës, e cila ndodhet në të djathtë të grykëderdhjes së lumit Drin me një sipërfaqe prej 20 ha, dhe me një thellësi deri në 13-14 m. Për nga thellësia kjo mund të konsiderohet edhe si një liqen i vogël natyral.

Laguna e Merxhanit që ndodhet në të djathtë të grykëderdhjes së lumit Drin, ka një sipërfaqe prej 300 ha, me një thellësi mesatare 0.75 m, dhe maksimalja deri në 1.3 m.

Laguna e Zajes së Cekës në Vain ndodhet në të majtë të grykëderdhjes së lumit Drin dhe ka një sipërfaqe prej 710 ha, thellësia mesatare është 0.5 m dhe maksimalja 1.3 m.

Laguna e Patokut, ndodhet përgjatë bregdetit të Adriatikut, në zonën ndërmjet lumit Mat në Veri dhe Lumit Ishëm në jug, në zonën e Fushe-Kuqes ka një sipërfaqe prej 2200 ha, thellësia mesatare është 1.1 m dhe maksimalja 2 m.

Turizmi lumor

Lumi Drin, është lumi më i gjatë i Shqipërisë, ky lumë, ka një gjatësi prej 283 km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5817 km². Mbi këtë lumë, janë ndërtuar tre hidrocentrale përkatësisht ai i Fierzës, i Komanit dhe i Vaut të Dejës. Drini formohet nga dy degë kryesore që janë Drini i Zi dhe drini i Bardhë. Drini i Lezhës fillon në afërsi të fshatit Mjedë të Rrethit Shkodër, bashkohet me ujërate lumit Gjader dhe me ujërat e Zadrimës kalon përbri qytetit të Lezhës dhe derdhet në detin Adriatik.

Lumi Gjader, buron nga lartësitë e bjeshkëve të Kashnjetit të lezhës e të Tërbunit të Pukës. Ka një gjatësi prej 40.5 km, nga kjo në rrethin e Lezhës janë 10 km, me një

pellg ujëmbledhës prej 120 km².

Fani i Madh, buron nga Qafa e malit e bjeshka e Munedhës, ka një gjatësi prej 94.4 km dhe pellg ujëmbledhës prej 542 km².

Fani i Vogël, buron nga Qafa e Kumbullës në Mirditë dhe ka një gjatësi prej 60 km , e një pellg ujëmbledhës prej 415 km². Fani i madh dhe Fani i Vogël, bashkohen në Vaun Rrasë e prej andej bashkohen me lumin Mat në Skuraj të Kurbinit e më pas derdhen në detin Adriatik.

Lumi Mat, është 97 km i gjatë, buron nga mali i Kaptinës në Martanesh të rrethit të Matit. Në zonën e Kurbinit ka një gjatësi prej 16 km dhe në zonën fushore të rrjedhjes së tij ka një gjerësi shtrati nga 400 m tek ura e Matit deri në 1 km afër grykëderdhjes së tij.

Lumi i Drojës, buron nga vargmalet Skenderbe, në malisinë e Krujës, rrjedh në drejtim të perendimit, duke përshkruar zonat Noje, Mafsheq, Shëmri, Shpërdhet, Mamurras, Bushnesh, Fushë Mamurras, Adriatik dhe derdhet në detin Adriatik. Në zonën e Krujës formohen dy gryka të thella, që janë Shkalla e Vajës dhe gryka e Zezë.

Përveç këtyre mund të përmendim edhe disa lumenj (përrenj) që janë më të vegjël, që janë në rajonin tonë si: Lumi i Urakës që buron në Selitë e derdhet në liqenin e Ulëzës, përroi i Luzhisë dhe i Qershisë në Komunën e Kallmetit, përroi i Trashanit në komunën Blinisht, përroi i Manatisë në Komunën Kolsh, përroi I Dibrit dhe Shpërdhazës në Komunën Kaçinar, Zmeja në Rrëshen, përroi i Urdhazës, i cili buron në lindje të fshatit Gërnac dhe derdhet në Lumin Mat afër grykës së Shkopetit.